



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE



Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport Inspektimi Nr: 5/2015

**INSPEKTIMI MBI ZBULIMIN DHE HETIMIN E
KRIMIT SI DHE ADMINISTRIMIN E RASTEVE**



(KORRIK 2015)

**Aprovuar
Fitim Shishani
Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së**

SHKURTESAT

<i>MPB</i>	<i>Ministria e Punëve të Brendshme</i>
<i>IPK</i>	<i>Inspektorati Policor i Kosovës</i>
<i>PK</i>	<i>Policia e Kosovës</i>
<i>DPP</i>	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës</i>
<i>DH</i>	<i>Departamenti i Hetimeve</i>
<i>DKKO</i>	<i>Divizioni Kundër Krimit të Organizuar</i>
<i>DHK</i>	<i>Divizioni për Hetimin e Krimit</i>
<i>DHKO</i>	<i>Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar</i>
<i>DHTN</i>	<i>Drejtoria për Hetimin Trafikimit me Narkotik</i>
<i>DHTQNJ</i>	<i>Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore</i>
<i>DHKR</i>	<i>Drejtoria për Hetimin e Krimit</i>
<i>DHKEK</i>	<i>Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit</i>
<i>DKT</i>	<i>Drejtoria kundër Terrorizmit</i>
<i>KPK</i>	<i>Kodi Penal i Kosovës</i>
<i>KPPK</i>	<i>Kodi i Procedurës Penale të Kosovës</i>
<i>PSO</i>	<i>Procedura Standarde e Operimit</i>
<i>DRP</i>	<i>Drejtoria Rajonale Policore</i>
<i>SIPK</i>	<i>Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës</i>
<i>TQNJ</i>	<i>Trafikim me Qenie Njerëzore</i>

P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	(4-5)
2. HYRJE.....	(6-7)
3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE NË PËRGJITHËSI.....	(8)
3.1. Vlerësimi i strukturës organizative dhe kapaciteteve njerëzore për zbulimin dhe hetimin e krimit.....	(8-12)
3.2. Identifikimi i dokumenteve dhe respektimi i tyre për zbulimin dhe hetimin e krimit.....	(12-16)
3.3. Vlerësimi i përformancës në kuadër të njësive hetimore.....	(16-21)
3.4. Menaxhimi i dosjeve penale nga PK-ja.....	(22-25)
4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET.....	(26)
4.1 Përfundimet.....	(26-27)
4.2 Rekomandimet.....	(28-29)
5. PLANI PËR PËRMBUSHJEN E REKOMADIMEVE.....	(30-33)

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, neni 23 dhe neni 24 paragrafi 2, Departamenti i Inspektimeve ka zhvilluar inspektim të rregullt në tri nivelet hetimore të Policisë së Kosovës dhe atë në qendror në Departamentin e Hetimeve, rajonal në Drejtoritë Rajonale dhe lokal në Stacionet Policore të kategorisë 'B'.

1.2 Inspektimit në këtë fushë i ka parapri faza hulumtuese dhe hartimi i programit inspektues duke përfshi edhe përzgjedhjen e metodologjisë së punës. Inspektimi ka filluar me datë 16.03.2015 dhe ka përfunduar më 21.04.2015. Periudha vlerësuese në këtë raport përfshinë periudhën kalendarike 01.01.2014 deri më 31.12.2014.

1.3 Inspektimi në këtë fushë përmes të gjeturave do të vënë në pah mënyrën e organizimit të hetimeve, respektimin e infrastrukturës ligjore, performacën dhe administrimin e rasteve penale në të tri nivelet hetimore në PK që për qëllim kanë hetimin dhe zbulimin e krimit.

1.4 Të gjeturat tregojnë se PK në kuptimin e organizimit të hetimeve ka tri nivele hetimore atë qendror në Departamentin e Hetimeve, rajonal në Drejtoritë Rajonale dhe lokal në Stacionet Policore të cilat ende nuk kanë arritur që të jenë të plota në aspektin organizativ dhe inspektimi ka pa si nevojë ristrukturimin, sidomos në nivelin qendror të hetimeve. Vlen të theksohet që duke pasur parasysh se organizatat policore janë mjaft dinamike, PK është e angazhuar në drejtim që të përfill strukturën organizative sa i përket shpërndarjes së personelit por që ka pasur raste të tejkalimit apo shkëputjes (hapësirave) në nivelin hierarkikë të gradave.

1.5 Policia e Kosovës është angazhuar në drejtim të krijimit të një infrastrukture ligjore përcjellëse të cilat kanë rrjedhur nga infrastruktura ligjore bazë me qëllim që të precizojë dhe lehtësojë qasjet ndaj veprimeve hetimore. Krijimi i formularëve, përcaktimi i specifikave- rrethanave në procedurën standarde të operimit për kompetencën lëndore, do të reflektonte pasqyrim më të qartë dhe lehtësim në angazhimet e përditshme hetimore si dhe do të krijonte siguri për çfarëdo mosmarrëveshje në mes tri niveleve hetimore kur ato përcaktohen si kategori në kompetencë lëndore për të njëjtën vepër penale.

1.6 Të tri nivelet hetimore kanë treguar angazhim në drejtim të hetimit dhe zbulimit të veprave penale ku të dhënat tregojnë që në nivelin e përgjithshëm të organizatës performanca policore është në nivel të kënaqshëm ku nga gjithsej 47076 raste kanë arritur që të zbulojnë 31283 nga to apo 66% të tyre, gjersa kanë mbetur nën hetime 15793 raste apo 34% e tyre. Ndërsa në veçanti tek niveli qendror i hetimeve DHKEK ka arritur që nga gjithsej 499 raste të zbulojë 432 nga to apo 87% të rasteve, kurse në nivelin rajonal DRP-Gjilan nga gjithsej 165 raste ka zbuluar 150 nga to apo 91% të rasteve.

1.7 Vlen të theksohet që deri sa disa nga drejtoritë kanë treguar performacë të mirë në drejtim të zbulimit të krimit në anën tjetër disa nga drejtoritë siç janë DHTN me 640 raste, DRP-Prishtinë me 532 raste dhe DRP-Ferizaj me 279 kanë qenë më të ngarkuara si në raport me rastet ashtu edhe në raport me hetuesit që i kanë të angazhuara në njësit e tyre.

1.8 Sa i përket menaxhimit të dosjeve penale të gjeturat tregojnë që në tri nivelet hetimore administrimi i rasteve bëhet në bazë të praktikave të krijuara gjatë punës, por kërkohet angazhim në drejtim të krijimit të standardeve të unifikuara sa i përket mirëmbajtjes së dosjeve hetimore, folderëve përmbajtjesor, librave zyrtarë të evidentimit (hyrje-dalje) në arkivat (dhomat e dosjeve).

1.9 Në të tri nivelet hetimore, dosjet hetimore ruhen në arkiva (dhoma dosjeve), të cilat në disa nga njësitë për shkak të mungesës së hapësirave ato improvizohen si hapësira për arkiv. Kështu që kërkohet përkushtim në drejtim të krijimit hapësirave për dosjet hetimore në mënyrë të mirëfilltë me rafte, regjistra fizik dhe procedura që lehtësojnë sistemimin dhe akomodimin e dosjeve hetimore.

1.10 Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport, IPK me datë 13.08.2015, ka mbajtur edhe takimin përmblyës me menaxhmentin e PK-së të fushës përkatëse. Në këtë takim janë diskutuar të gjitha detajet e paraqitura në raport ku si konkluzion i këtij takimi ka dalë se të gjithë të pranishmit janë pajtuar me këto të gjetura.

1.11 Me datën 20.08.2015 IPK-ja ka pranuar nga Departamenti i Hetimeve, Planin e veprimit në realizimin e rekomandimeve, në të cilin është konstatuar se disa nga rekomandimet e dhëna në raport janë realizuar, disa të tjera janë në proces të përmbushjes.

2. HYRJJE

2.1 Bazuar në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) është zhvilluar inspektimi i zakonshëm me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, lidhur me zbulimin dhe hetimin e krimit si dhe administrimin e rasteve në Policinë e Kosovës (PK). Ky inspektim i funksionalizuar nga Departamenti i Inspektimit është zhvilluar nga data 16 mars deri më 15 prill 2015. Gjatë Inspektimit janë vizituar: Departamenti i Hetimeve në kuadër të DPP-së, Sektorët Rajonal të Hetimeve në Drejtoritë Rajonale Policore dhe njësitë hetimore të tetë stacioneve policore të kategorisë "B" në tetë drejtori rajonale policore. Fokusi i inspektimit ka përfshi verifikimin e të dhënave për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2014 dhe gjendja aktuale e DH-se, DHR dhe njërive hetuese në stacione policore të kategorisë B.

2.2 Qëllimi i organizimit të këtij inspektimi ka qenë:

- Të vlerësojë se PK-ja ka ndërtuar një strukturë organizative dhe ka kapacitete humane për zbulimin dhe hetimin e krimit, pastaj ka nxjerrë aktet e domosdoshme ligjore të cilat e lehtësojnë punën e policisë në hetimin dhe zbulimin e krimit si dhe performancën e njërive hetimore në zbulimin e krimit dhe administrimin sa më të mirë të rasteve hetimore.

2.3 Rëndësia e këtij inspektimi bazohet në Ligjin për IPK-në, me qëllim që të shikohet puna hetimore dhe zbulimi i krimit në PK, ku dihet se mbarëvajtja dhe puna e PK-së në masë të madhe lidhet me hetimin dhe zbulimin e krimit. Kriteri matës dhe kyç i suksesit të saj ka të bëjë me atë se sa efikase është PK-ja në luftimin dhe zbulimin e krimit në Kosovë, sa i ka ndërtuar kapacitete e saja; në cilën fazë janë në kompletimin e tyre organizativ; sa kanë ndërtuar infrastrukturën ligjore deri më tani duke krahasuar vitet e mëhershme të funksionimit të saj, si dhe vlerësimin e punës së tyre në raport me zbulimet e krimeve dhe administrimin e duhur të rasteve penale.

2.4 Objektivi që ka arritur ky inspektim është:

1. Vlerësimi i strukturës organizative dhe kapaciteteve njerëzore për zbulimin dhe hetimin e krimit;
2. Identifikimi i dokumenteve dhe respektimi i tyre për zbulimin dhe hetimin e krimit;
3. Vlerësimi i performancës në kuadër të njërive hetimore;
4. Menaxhimi i dosjeve penale nga PK-ja.

2.5 Periudha mbuluese e kësaj fushë inspektimit përfshinë periudhën prej 01.01.2014-31.12.2014

2.6 Si kriter matës Inspektorati Policor i Kosovës ka marrë:

- Kodi Penal i R. së Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale;

- Ligji i Policisë;
- Doracaku i Parimeve dhe Procedurave;
- Procedura Standarde e Operimit (ZDPO/02/021/2013); si dhe
- Strategjitë Nacionale të Qeverisë së Kosovës për luftimin e krimit dhe Strategjitë e PK-së në këtë drejtim.

2.7 Inspektimi është përqendruar në këto drejtime kryesore:

- Baza ligjore që rregullon fushën e hetimeve.
- Plotësimi i formularëve standard që kanë të bëjnë me hetimin dhe dokumentimin e krimit.
- Sistemet teknologjike dhe programet e përdorura në evidentimin e rasteve penale.
- Kontrollimin dhe analizimin e raporteve vjetore të secilës njësi dhe kontrollimin e dosjeve hetimore.
- Zyrat -hapësirat ku janë të përqendruara personeli hetues dhe arkiva për ruajtjen e dosjeve penale.
- Mjete e punës që ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejt me fushën e hetuesisë.

2.8 Metodologjia: Ky inspektim është zhvilluar me metodën e marrjes së dokumentacionit relevant në bazë të të cilit punojnë DH-ja, raportet dhe planet vjetore, analizimin dhe vlerësimin e dosjeve hetimore, intervistimin, vëzhgimin-fotografimin dhe kontrollimin fizik të dokumenteve.

- **Vëzhgimi-Fotografimi:** janë vëzhguar punët e hetuesve gjatë kohës së inspektimit për t'u njoftuar me ngarkesën në detyrë, si dhe janë fotografuar të gjitha zyrat e arkivuese për t'u vërtetuar me kushtet e ruajtjes dhe sigurisë së dosjeve penale, mjetet e punës etj.
- **Kontrollimi fizik i dokumenteve:** janë kontrolluar raportet dhe planet vjetore për periudhën 2014 si dhe janë analizuar rastet penale të proceduara në prokuroritë kompetente me kallëzime penale të drejtorive në gjithë DH duke i përfshirë edhe hetimet rajonale dhe njësitë hetimore të stacioneve që i përkasin kategorisë "B" (një stacion për secilën DR). Po ashtu, është bërë kontrollimi fizik i librave për evidentimin e rasteve hetimore dhe librave të tjerë që i përdorin për evidentimin e çështjeve që kanë të bëjnë me procesin hetimor.

2.9 Gjatë rrjedhës së inspektimit, Inspektorët e IPK-se kanë intervistuar: në Departamentin e Hetimeve 12 zyrtarë policorë (personel i graduar); në Drejtoritë Rajonale janë intervistuar 16 zyrtarë policor, dhe në stacionet policore të kategorisë "B" janë intervistuar 16 zyrtar policor (komandant të stacioneve dhe shefat e njësive të hetimeve).

3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE NË PËRGJITHËSI

3.1. Vlerësimi i strukturës organizative dhe kapaciteteve njerëzore për zbulimin dhe hetimin e krimit

3.1.1 Struktura Organizative e PK-së paraqet formën organizative drejt funksionimit sa më efikas të saj dhe rëndësinë e kësaj organizate në rolin e parandalimit dhe luftimit të krimit si dhe në drejtim të zbatimit të akteve ligjore pozitive. Një strukturë e qartë e PK-së do të thotë një ndarje e detyrave dhe përgjegjësive konform rolit që ka PK-ja për krijimin e një ambienti sa më të sigurt për qytetarët si dhe përpjekjet e saj për të ruajtur rendin dhe ligjin.


3.1.2 Në disa shtete, hetimi i krimit është i organizuar në mënyra të ndryshme: në disa prej tyre ai është në përgjegjësinë e policisë së përgjithshme, kurse në disa të tjera zbatohet prej degëve të veçanta të policisë (si policia kriminale apo policia gjyqësore). Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) është paraparë që secili polic në PK ka autorizime dhe përgjegjësi primare luftimin e krimit. Struktura e organizimit të tanishëm në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit nga Policia e Kosovës është e ndarë në tri nivele: lokal (stacione policore), rajonal (sektorët rajonal të hetimeve) dhe qendror (drejtoritë e specializuara hetimore në kuadër të Departamentit të Hetimeve, i cili është i vendosur në operativën e PK-së).

3.1.3 Në kuadër të strukturës organizative të PK-së të vitit 2012, Departamenti i Hetimeve, ka pësuar ndryshime duke i përmbledhë të gjitha drejtoritë hetuese qendrore në dy divizione për hetimin e krimit. Aktualisht, ky Departament është i ndarë në: Divizionin Kundër Krimit të Organizuar dhe Divizionin për Hetimin e Krimit. Po ashtu, duhet theksuar që DH nga dy divizionet në nivelin qendror ka të shpërndarë sektorë nëpër Drejtoritë Rajonale Policore. Duhet theksuar që në drejtim të luftimit të korrupsionit në kuadër të PK-së vepron edhe Task Forca Anti-Korrupsion.

3.1.4 Në kuadër të DKKO-së janë katër drejtori: Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, Drejtoria e Hetimit të Trafikimit me Narkotik, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore si dhe Drejtoria për Mbështetje të Hetimeve, ndërkaq në kuadër të DHK-së janë pesë drejtori të tjera: Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, Drejtoria Kundër Terrorizmit, Drejtoria për Inteligjencë dhe Analiza (DIA), si dhe Drejtoria e Teknikës Kriminalistike. Të gjitha këto drejtori në përshkallëzimet e tyre kanë brenda tyre sektorë të cilat janë të mbështetura në çështje të funksionalitetit dhe profilizimit për fushat konkrete të hetimeve. Referuar përbërjes strukturore të nivelit qendror vërehet se në dy divizionet janë të shpërndara drejtori të cilat kanë rol mbështetës për hetim të krimit (p.sh. Drejtoria për Mbështetje të Hetimeve, Drejtoria e Inteligjencës dhe Analizës dhe Drejtoria e Teknikës Kriminalistike).

3.1.5 Në këto dy divizione ka drejtori të përziera ku disa nga to merren me hetimin e krimit e disa tjera kanë rol mbështetës për drejtoritë që bëjnë hetimin e krimit (p.sh DMH aktivitetin e saj e realizon tek masat e vëzhgimit, përgjimit dhe e cila realisht mbështetë me këto veprime çdo drejtori e cila merret me hetim të rasteve).

Ndarja aktuale e Departamentit të Hetimeve



3.1.5 Në bazë të analizimit të strukturës aktuale të këtij departamenti nga IPK-ja, kjo mënyrë e organizimit paraqet nevojë për një ristrukturim brenda këtij departamenti. Sipas këtij ristrukturimi DH do të ndahej në dy divizione: Divizionin për Hetimin e Krimit dhe Divizionin e Shërbimeve Mbështetëse për Hetime, përparësia e të cilit paraqet një strukturë më të qartë hierarkike.

3.1.6 Me këtë ndarje DH-ja do të jetë më funksionale ku e tërë komponenti mbështetës do të jetë nën një divizion, ndërsa komponenti hetimor nën një divizion tjetër duke u shmangur nga ndonjë paqartësi në mes të këtyre dy funksioneve. Ky propozim ka për qëllim ndarjen e qartë të përgjegjësiave, vijat e komunikimit, raportimit, bashkëpunimit, duke filluar nga niveli i stacioneve, rajoneve dhe drejtorive në kuadër të DH-së. Po ashtu, kjo jep mundësinë që nëse paraqitet nevoja për krijimin e drejtorive të reja, të dihet se ku do të vendosen ato në strukturë

dhe cilit divizion hetimor i takojnë (p.sh. krijimi i drejtorisë për trajtimin e informatorëve, agjentët e mbuluar etj.).

3.1.7 Gjithashtu, duhet theksuar që në strukturën organizative DHKR brenda saj ka të funksionalizuar Njësinë e Dhunës Familjare dhe Delikuenca e të Miturve.¹ Mirëpo, bazuar çështjes së potencuar më lartë si dhe analizimit të KPK nuk ka një përputhshmëri në mes funksionalizimit strukturor të njësisë së dhunës në familje dhe KPK, pasi që shumë mënyra të dhunës në familje përbëjnë vepra të ndryshme penale të cilat janë të parapara në KPK dhe që trajtohen nga ana e njësive të tjera të profilizuara në PK.

3.1.8 Gjatë analizimit të strukturës aktuale të aprovuar nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë në vitin 2012, shtresëzimi i i niveleve në kuadër të divizioneve, drejtorive, njësive dhe sektorëve, bën që në PK të ketë numër të madh të stafit menaxherial. Kështu që tek të dhënat si më poshtë shihet numër më i madh i personelit të graduar sesa nevojat që ka paraparë struktura e aprovuar. P.sh. në DHKR ka 6 kapiten ndërsa sipas strukturës duhet të jenë 2, ose në DHKEK ka 12 toger në vend të 8 sa duhet të ketë si dhe i ka 39 rreshter nga 17 sa duhet të jenë. Ndërsa të dhënat për të gjitha drejtoritë në nivelin e dy divizioneve (tabela nr. 1) paraqet pasqyrimin e shpërndarjes së personelit.

DEPARTAMENTI I HETIMEVE										
POLICIA E KOSOVËS	PERSONELI I PK NË DEPARATAMENTIN E HETIMEVE ²									
	KOLONEL	NËNKOLONEL	MAJOR	KAPTEN	TOGER	RRESHTER	ZYRTAR POLICOR	TOTALI ZYRTAR STPOLICOR	SASF CIVIL	TOTTSALI I PERSONELIT
DKKO	0 (1)	1 (0)	0(0)	0 (0)	0 (1)	2 (1)	3(4)	6 (7)	1 (2)	7 (9)
DHKO	0 (0)	0 (1)	1(0)	1 (3)	3 (1)	14 (6)	20(33)	39 (44)	1 (4)	40 (48)
DHTN	0 (0)	0 (1)	1 (0)	1 (2)	8 (7)	27(17)	56(61)	93 (88)	1 (1)	94 (89)
DHTQNJ	0 (0)	0 (1)	1 (0)	0 (1)	7 (6)	15 (8)	31(39)	54 (55)	1 (1)	55 (56)
DMH	0 (0)	0 (1)	1 (0)	1 (2)	3 (4)	12 (8)	28(47)	45 (62)	2 (2)	47 (64)
DHK	0 (1)	1 (0)	0(0)	0 (0)	1 (1)	0 (1)	2(2)	4 (5)	1 (1)	5 (6)
DHKKR	0 (0)	0 (1)	0 (1)	6 (2)	6 (3)	7 (7)	22(24)	41 (38)	1 (1)	42 (39)
DHKEK	0 (0)	1 (1)	1 (1)	3 (3)	12 (8)	39(17)	67(66)	123(96)	5 (4)	128 (100)
DIA	0 (0)	1 (1)	0 (1)	2 (3)	7 (7)	13(17)	27(37)	50 (66)	2 (4)	52 (70)
DKT	0 (0)	0 (1)	2 (1)	2 (2)	1 (3)	8 (7)	18(42)	31 (56)	0 (4)	31 (60)
DTK	0 (0)	1 (1)	0 (0)	1 (1)	2 (2)	5 (5)	3(10)	12 (19)	3 (5)	15 (24)

Vërejtje: Tabela më lart paraqet personelin në DH dhe numrin e gradave të shpërndara në të gjitha drejtoritë e këtij departamenti. Numrat jashtë kllapave paraqesin gjendjen aktuale të personelit që është i shpërndarë në këto drejtori. Ndërsa, numrat brenda kllapave pasqyrojnë numrin e paraparë të personelit me strukturën e vitit 2012.

¹ Struktura Organizative Divizioni për Hetimin e Krimit

² Struktura Organizative, Lista Përcjellëse e Personelit

3.1.9 Edhe pas kalimit të një kohe prej momentit të aprovimit të strukturës organizative gjate vitit 2012, gjatë analizimit të strukturës aktuale me personel vërehet se ende nuk është arritur të përmbushet me personel të graduar (ose në disa raste e ka kaluar atë) dhe zyrtar policor ashtu si e kërkon struktura dhe të sigurohet një shpërndarje e njëtrajtshme e personelit.

3.1.10 Sa i përket drejtorive rajonale, hetimet janë të strukturuar në kuadër të Sektorit Rajonal për Hetime duke u ndarë në Njësinë për Hetime të Përgjithshme (NJHP) dhe Njësinë e Teknikës Kriminalistike (NJTK). Ky strukturim i DR-ve sipas zyrtarëve policor të intervistuar është funksional, me kompetenca të ndara për të dy njësitë e të cilat i japin llogari Shefit të Sektorit Rajonal për Hetime. Duhet cekur se me krijimin e dy drejtorive të reja rajonale, DRP e Gjakovës dhe DRP e Mitrovicës së Veriut, sektorët e hetimeve në këto dy drejtori janë në organizim e sipër të strukturës organizative si dhe plotësimin e saj me stafin adekuat për hetime.

PERSONELI I SIPAS GRADAVE NË PK ³										
	KOLONEL	NËNKOLONEL	MAJOR	KAPITEN	TOGER	RRESHTER	POLIC	TOTALI ZYRTAR STPOLICOR	STAF CIVIL	TOTALI I PERSONELIT
Sektori i Hetimeve Rajonale										
Prishtinë	0 (0)	0 (0)	0 (0)	1 (1)	2 (0)	12 (6)	24(34)	39 (41)	6 (4)	45 (45)
Prizren	0 (0)	1 (1)	0 (0)	1 (2)	2 (0)	7 (8)	21(21)	32 (32)	1 (4)	33 (33)
Ferizaj	0 (0)	0 (1)	0 (0)	2 (2)	1 (0)	6 (8)	14(20)	23 (31)	1 (4)	24 (35)
Gjilan	0 (0)	0 (1)	0 (0)	2 (2)	1 (0)	7 (8)	17(20)	27 (31)	1 (4)	28 (35)
Peja	0 (0)	0 (1)	1 (0)	1 (2)	1 (0)	9 (8)	25(22)	37 (33)	1 (4)	38 (37)
Mitrovicë Jugu	0 (0)	0 (0)	0 (0)	1 (1)	1 (0)	5 (7)	19(24)	26 (32)	1 (0)	27 (32)
Mitrovicë Veri	0 (0)	0 (1)	0 (0)	0 (2)	1 (0)	2 (8)	15(19)	18 (30)	1 (5)	19 (35)
Gjakovë	0 (0)	0 (1)	1 (0)	2 (2)	0 (0)	2 (8)	6 (21)	11 (32)	0 (4)	11 (36)
Sektori i Hetimeve në Stacione Policore										
Lipjan	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (1)	1 (2)	10(11)	11 (14)	0 (0)	11 (14)
Suharekë	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (0)	1 (1)	2 (2)	12 (8)	15 (11)	0 (0)	15 (11)
Kaçanik	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (1)	1 (2)	8 (8)	9 (11)	0 (0)	9 (11)
Kamenicë	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (0)	1 (1)	2 (2)	8 (8)	11 (11)	0 (0)	11 (11)
Klinë	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (1)	3 (3)	8 (10)	12 (14)	0 (0)	12 (14)
Skenderaj	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (0)	1 (1)	3 (3)	9 (10)	13 (14)	0 (0)	13 (14)
Leposaviq	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (1)?	0 (0)	1 (3)	5 (13)	6 (17)	0 (0)	6 (17)
Rahovec	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (0)	0 (1)	2 (2)	7 (7)	9 (10)	0 (0)	9 (10)

³ Struktura Organizative, Lista Përcjellëse e Personelit

3.1.11 Siç shihet në tabelën e paraqitur më lart (nr. 2), e njëjta gjendje e mos përmbushjes së strukturës organizative me personel është gjetur edhe në sektorët e hetimeve rajonale dhe në sektorët e hetimeve të stacioneve policore të kategorisë “B”.

3.1.12 Në PK që nga krijimi i strukturës së fundit organizative ka pasur disa procese të gradimit me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe plotësimit të strukturës së aprovuar me gradat e duhura. Duke u nisur nga drejtoritë qendrore të hetimit e gjer tek hetimet në nivel stacioni shihet që nuk është përmbushur me grada struktura organizative që është aprovuar edhe pas zhvillimit të proceseve të gradimit.

3.1.13 PK-ja duhet që të bëjë analiza dhe në bazë të nevojave për grada të bëjë edhe propozimet e duhura në mënyrë që avancimet në grada të jepen në proporcion me nevojat strukturale qoftë të drejtorive qendrore hetimore, rajonale apo edhe në stacione policore. Së këndejmi, personeli aktual i graduar të shpërndahet sipas nevojave në rajone apo stacione policore dhe të mos mbetet i koncentruar në ato vende ku grada i tejkalon nevojat strukturale (p.sh. drejtoritë qendrore të hetimit).

3.1.14 Duke pasur parasysh që Ligji Për Policinë ka përcaktuar nivelin e gradave nga më i ulëti si polic i ri e deri në më të lartin në kolonel⁴ të cilat tregojnë dhe hierarkinë në organizatë atëherë një dukuri tjetër që është hasur gjatë inspektimit ishte shkëputja në mes gradave policore menaxheriale në drejtoritë hetimore të PK-së.

3.2. Identifikimi i dokumenteve dhe respektimi i tyre për zbulimin dhe hetimin e krimit

3.2.1 Puna e PK-së në masë të madhe lidhet me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit. Policia e Kosovës ndërmerr veprime hetimore dhe masa te nevojshme që të zbulojë veprat penale dhe kryerësit e tyre, të grumbulloje informata te nevojshme për vendndodhjen e kryerësve të veprave penale, të zbulojë dhe të ruaj gjurmët dhe provat e tjera të cilat kontribuojnë në zbardhjen e kryerësit së veprës penale dhe të mbledhë të gjitha informatat e nevojshme për paraqitje në procedurë penale.

3.2.2 Policia e Kosovës në kuadër të zbulimit dhe hetimit të krimit bazën ligjore e ka mjaft të pasur mbi të cilën mbështeten veprimet hetimore nga ana e zyrtarëve policor. Kodi Penal i Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës dhe Ligji për Policinë janë ligjet kryesore që parashikojnë dhe rregullojnë punën hetimore të policisë. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ndër rolet kryesore të hetimit të krimit janë paraparë veprimet e policisë në hetimin dhe zbulimin e krimit e të cilat veprime të policisë janë të parapara në kapitullin IX pika 2 të precizuara si

⁴ Ligji për Policinë neni 45

‘Veprime Fillestare Policore që nga neni 69 deri në nenin 83⁵ si dhe mbështetjen që i japin organeve të ndjekjes. Ndërsa edhe shumë veprime tjera të cilat parashihen në KPPK realizohen me autorizime të veçanta ashtu siç edhe ka paraparë ky kod. Vlen të theksohet që KPPK ka paraparë një mori autorizimesh, detyra dhe të drejta të cilat ndihmojnë policinë në identifikimin dhe luftimin e krimit.

3.2.3 Referuar KPPK-së Policia e Kosovës konkretisht policët që ndërmarrin veprime hetimore përpos të drejtave që i kryejnë në bazë të autorizimeve që posedojnë, natyrshëm iu rrjedhin edhe detyrat përmes së cilave përmbushin obligimet e tyre. Andaj, referuar kësaj policia për veprimet të cilat i ndërmarrin, për faktet dhe rrethanat e konstatuara nga hetimet e tyre, përpilon procesverbal, fotografi ose shënim zyrtar⁶. Gjatë kontrollimit të rasteve hetimore si dhe analizimit të dokumenteve që lidhen me fushën përkatëse është vënë në pah se në përmbajtje të disa lloj shkresave përfshinë këto standarde të përcaktuara nga kodi procedural. Por, IPK ka gjetur se në që të tri nivelet hetimore nuk posedojnë ndonjë dokumentacion (formular) i cili në vetvete do të përfshinte trembëdhjetë autorizimet policore si të drejta të policisë që posedon për të ndërmarrë veprime hetimore dhe varësisht nga veprimi i ndërmarrë të bashkëngjitet qoftë procesverbali, shënimi zyrtar dhe fotografitë.

3.2.4 Duhet theksuar që KPPK, ka paraparë si detyrim policor çështjen që kur krijohet ‘dyshimi i arsyeshëm’ se është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare policia brenda njëzet e katër (24) orëve t’i dorëzojë një raport informues prokurorit të shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurën penale⁷. Kështu që, gjatë inspektimit është vënë në pah se që në të tri nivelet hetimore në PK, po sa të kenë dyshimin e arsyeshëm se është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare brenda 24 orëve, zakonisht përmes thirrjes telefonike, informojnë prokurorin kompetent të shtetit dhe përjashtimisht në ndonjë rast më të rëndësishëm përpilojnë raport policor të cilin ia dorëzojnë prokurorit të shtetit i cili më pastaj do të vendosë se a duhet filluar procedurën penale.

3.2.5 Duke pasur parasysh që KPK dhe KPPK kanë hyrë në fuqi më 01.01.2013, si dhe bazuar në analizimet në relacion me përgjegjësitë policore përveç tjerash, ka paraparë Policinë e Kosovës si kategori e cila mund të paraqitet në kapitullin IX pika 4 ‘Fillimi i Procedurës Penale’ në emërtimin C tek neni 146 dhe 147 me të cilin rast policia mund të autorizohet si ekspert në analizat kompjuterike dhe analizat financiare. Andaj, referuar kësaj çështje inspektorët kanë vënë në pah se departamenti i hetimeve është angazhuar në drejtim të plotësimit të kriterit të përcaktuar të KPPK duke përpiluar procedurën lidhur me Analizat Kompjuterike gjithnjë në përputhje me nenin 147, si dhe Analizat Financiare në përputhje me nenin 148 të KPPK-së.

3.2.6 DH në kuadër të DPP-së, hetimet rajonale në kuadër të DRP-ve dhe njësitë policore hetuese të stacioneve policore të kategorisë “B” të cilat kanë qenë subjekt i inspektimit, punën e tyre e

⁵ KPPK 01.01.2013

⁶ KPPK Neni 70, parag. 3

⁷ KPPK neni 70 parag.4

mbështesin edhe në akte të tjera normative si: Udhëzime Administrative, Procedurat Standarde të Operimit, Parimet dhe Procedurat e Policisë së Kosovës, Strategjitë Nacionale të Qeverisë së Kosovës për luftimin e krimit dhe Strategjitë e PK-së në këtë drejtim.

3.2.7 Zv. Drejtori i Përgjithshëm për Operativë ka hartuar një PSO (ZDPO/02/023/2013) e cila përcakton mënyrën e procedimit të lëndëve dhe kompetencën lëndore të hetimit. Kjo PSO në përmbajtjen e saj rregullon mbarëvajtjen e procesit hetimor prej momentit të pranimit të informatës për shkelje ligjore-penale e deri tek kompletimi i rastit dhe procedimi i tij. Njëkohësisht në këtë PSO është paraparë edhe kompetenca lëndore për veprat penale sipas KPK. Veprat penale sipas KPK janë caktuar në kompetence lëndore sipas natyrës së veprës penale, mirëpo, në disa raste, veprat e njëjta penale janë paraparë që të jenë në kompetencë lëndore të të tri niveleve.

3.2.8 Për shkak të mos rregullimit të specifikave-rrethanave të rasteve dhe natyrës së tyre lidhur me përkatësinë e kompetencës lëndore apo mos definim i mirëfilltë i kompetencave kjo PSO në praktikë mund të paraqet vështirësi në procesin hetimor në drejtim të luftimit të krimit. Shpeshherë, disa kategori të veprave penale i janë dhënë në kompetencë lëndore për hetim të tri niveleve (nivelit lokal, regjional dhe atij qendror) dhe si rrjedhojë paraqitet konflikt kompetencash lëndore mes niveleve hetimore⁸. Bartja nga një nivel hetimor në nivelin tjetër, paraqet një vakuum të procesit të grumbullimit të provave dhe informatave drejt zbulimit të veprave penale dhe kryerësit e tyre.

3.3.9 Po ashtu, inspektimi ka gjetur se në disa stacione policore të inspektuara referuar kompetencave lëndore ka dallime në drejtim të trajtimit të rasteve hetimore. Përderisa në disa stacione policore (p.sh. s. p. Lipjan) në momentin që ndodh një rast me elemente të veprës penale edhe pse puna kryhet nga ekipet patrulluese policore pavarësisht me kryes të njohur apo të panjohur puna finale i lihet ekipit të hetuesisë, mirëpo, në disa stacione tjera policore (p.sh. Kaçanik, Kamenicë) kur ekzistojnë të gjitha ato që u cekën më sipër rastet i kryejnë vetë ekipet patrulluese, përveç rasteve kur nuk dihet kryerësi i veprës penale. Përveç kësaj mënyre të trajtimit të rasteve që ndodhin në stacionet policore të inspektuara, një ndarje tjetër e trajtimit të rasteve në bazë të kompetencave lëndore është hasur në Leposaviq ku ata i trajtojnë rastet penale të dënueshme deri në pesë vite.

3.2.10 Përveç PSO-së së cekur më lart në disa rajone kemi hasur procedura për çështje hetimore dhe kompetenca lëndore të aprovuara nga vet drejtoritë rajonale në vite të më hershme⁹ dhe stafi i tyre shërbehet me to pavarësisht se kanë ndryshuar KPK dhe KPPK si dhe është nxjerrë PSO-ja për kompetencën lëndore duke u bazuar pikërisht në ndryshimet ligjore të këtyre dy kodeve.

⁸ Rasti me nr. 2014-AB-4101-Mundësim ose Detyrim në Prostitucion, në bazë të kompetencës lëndore është dashur ekskluzivisht të trajtohet nga DHTQNJ, por i është lënë për hetim Njësisë Rajonale Hetuese Prishtinë

⁹ DRP Mitrovicë e Jugut PSO-Janar 2010, dhe DRP Prizren PSO - Prill 2010

3.2.11 Gjatë zhvillimit të inspektimit në stacionet policore te kategorisë “B”, kemi hasur në disa raste kur kemi kërkuar dokumentacionin aktual (PSO) me të cilin shërbehen për punën hetimore dhe ata nuk kanë poseduar dokumentet e kërkuara. (Kamenicë, Rahovec).

3.2.12 Përgjithësisht, PK-ja duhet të bëjë njoftime në të gjitha nivelet hetuese se cilat ligje, udhëzime, procedura dhe strategji janë në fuqi për punën e tyre. Përveç kësaj, është detyrë e menaxhmentit të PK-së që të informojë personelin hetues për çdo ndryshim apo edhe plotësim të akteve ligjore që shërbejnë për punën hetimore në PK.

3.2.13 PK-ja duhet të bëjë përpjekje që të gjitha procedurat standarde që lidhen me punën hetimore të përpilohen në një të vetme si tërësi dhe e njëjta t’u shpërndahet të gjitha niveleve hetuese me qëllim të standardizimit dhe përmbajtjes unike për të gjitha këto kategori hetuese.

3.2.14 Politikat qeveritare në nivel të vendit kanë hartuar dokumente strategjike që kanë për qëllim parandalimin dhe luftimin e krimit në Kosovë. Në nivel të qeverisë janë hartuar strategji të cilat japin obligime dhe plane veprimit PK-së në drejtim të parandalimit dhe luftimit të krimit në Kosovë. Si strategji më të rëndësishme janë: Strategjia Nacionale kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe Plani i Veprimit 2011-2014; Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës dhe Plani i veprimit për menaxhimin e integruar të kufirit 2013-2018; Strategjia Kombëtare dhe plani i veprimit kundër drogave të Republikës së Kosovës 2012-2017; Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës dhe Plani i veprimit kundër terrorizmit 2012-2017; Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër krimit të organizuar dhe Plani i Veprimit 2012-2017; Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin e krimit dhe Plani i Veprimit 2013-2017; Strategjia dhe Plani i Veprimit për kontrollimin dhe mbledhjen e armëve të vogla dhe të lehta 2013-2016; Strategjia Nacionale dhe plani i Veprimit për Sigurinë në Bashkësi 2011-2016; Strategjia për RPR Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për RPR 2014-2016; Strategjia Shtetërore për Migracion dhe Plani Veprimit 2013 - 2018.

3.2.15 Pas hartimit të këtyre dokumenteve strategjike, në nivel vendi janë hartuar edhe Planet e Veprimit për secilin dokument strategjik me qëllim të realizimit të detyrave që dalin nga këto strategji.

3.2.16 Luftimi i krimit në Kosovë nuk është aktivitet që duhet të ndërmerret vetëm nga Policia e Kosovës, andaj strategjitë e hartuara potencojnë edhe mekanizmat për arritjen e objektivave të parapara strategjike. Secila nga këto dokumente strategjike ka caktuar edhe prioritetet, duke nxjerrë në pah pozitën dhe funksionin e Policisë së Kosovës si bartës kryesor në zbatimin e atyre prioriteteve, duke qenë e përkrahur nga mekanizmat tjerë relevant shtetëror. Mirëpo, PK-ja shihet si faktori më i rëndësishëm në procesin hetimor por në lidhshmëri edhe me institucionet tjera, si: prokurorinë, gjykatat, doganën dhe shumë agjencione tjera të sigurisë. Funksionimi i përbashkët i tërë këtij organizimi ofron mundësinë e luftimit të aktiviteteve kriminale.

3.2.17 Lidhur me identifikimin e dokumenteve gjatë inspektimit ka dal në pah nevoja për krijimin e një manuali në të cilin do të përfshiheshin të gjitha aktet ligjore me të cilat shërbehen subjektet hetuese në PK si dhe unifikimin e të gjitha PSO-ve që kanë të bëjnë me kompetencat lëndore dhe procedimin e rasteve.

3.3. Vlerësimi i performancës në kuadër të njësive hetimore

3.3.1 Performanca hetimore e Policisë së Kosovës paraqet tërësinë e veprimeve të ndërmarra dhe mënyrën se si ajo i heton dhe zbulon rastet kriminale. Performanca e mirë në drejtim të luftimit të krimit paraqet edhe treguesin apo matësin e qartë të besueshmërisë së këtij institucioni tek qytetarët.

3.3.2 Hetimet penale përveç që ju referohen personave në fjale për të konstatuar faktet, mbledhur provat dhe të akuzimit për sjellje kriminale, hetimet gjithashtu përfshijnë edhe një proces ligjor siç është “Kodi Penal i Kosovës ” dhe “Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.” Kështu që Policia e Kosovës në drejtim të përfilljes së këtyre obligimeve ligjore që ka, është angazhuar duke ndërmarrë veprime me qëllim që të përmbush detyrimet e saj.

3.3.3 Duke pasur parasysh që pas pranimi të informatës për ndonjë vepër penale të dyshuar, policia heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare të jetë kryer, atëherë në përputhje të këtij parimi Policia e Kosovës në të tri nivelet hetimore është angazhuar në hetime duke ndërmarrë veprime me qëllim të zbatimit të ligjit si detyrë reaktive policore.

3.3.4 Në tabelën më poshtë kemi paraqitur të dhënat komplete lidhur me numrin e rasteve të hetuara nga zyrtarët policor në të tri nivelet hetimore (lokal, rajonal dhe qendror) për periudhën kohore 2014. Nga të dhënat në nivel vendi PK-ja gjatë këtij viti ka trajtuar **47076** raste, ku prej tyre **31283** janë proceduar në prokuroritë kompetente ndërsa kanë mbetur ende për hetim të mëtejme **15793** raste apo 34% e tyre. Po ashtu, të dhënat tregojnë se nga numri i përgjithshëm i hetuesve në nivel vendi del se një zyrtar policor mesatarisht gjatë një viti heton 46 raste.

Tab. 3 Numri i rasteve dhe zbulueshmëria e tyre në të tri nivelet hetimore për vitin 2014 ¹⁰							
	Nr. i rasteve	Të zbuluara dhe %		Nën hetime		z. Policor	Nr. i rasteve për z. policor
DHKO	78	39	50%	39	50%	39	2
DHTN	640	482	75%	158	25%	93	7
DHTQNJ	155	110	71%	45	29%	54	3
DHKR	49	31	63%	18	37%	41	1
DHKEK	499	432	87%	67	13%	123	4
DKT	60	34	57%	26	43%	31	2
NJHR Prishtinë	532	413	78%	119	22%	36	21
NJHR Pejë	224	184	82	40	18	28	6
NJHR Mitrovicë Veri	91	71	78%	20	22%	15	6
NJHR Prizren	229	203	89%	26	11%	29	8
NJHR Mitrovicë Jugu	225	189	84%	36	16%	28	8
NJHR Ferizaj	279	261	94%	18	6%	16	17
NJHR Gjiilan	165	150	91%	15	9%	21	8
<i>Stacionet "A"</i> <i>(11 stacione)</i>	26628	17277	65%	9351	35%	215	86
<i>Stacionet "B"</i> <i>(19 stacione)</i>	15109	9935	66%	5174	34%	202	56
<i>Stacionet "C"</i> <i>(10 stacione)</i>	2113	1472	70%	641	30%	37	42
<i>Gjithsej</i>	47076	31283	66%	15793	34%	1008	47

3.3.5 Referuar të dhënave nga raportet vjetore të drejtorive në DH si nivel qendror në PK, ato tregojnë angazhim në drejtim të veprimeve hetimore dhe marrë në përgjithësi kanë treguar një performacë të mirë duke arritur që të zbulojnë një numër të konsiderueshëm të veprave penale. Mirëpo, duhet theksuar që në këtë departament hetohen raste penale të një natyre më të rëndë dhe veprimet hetimore kërkojnë kohë, përfillje të procedurave të ndryshme ku përfshihen prokurori, gjyqtari dhe të cilat nuk reflektojnë drejtpërdrejt në obligimet policore. Në tabelën në vijim pasqyrohen të dhënat e drejtorive sa i përket numrit të hetuesve të angazhuar në raport me numrin e rasteve dhe zbulimin e tyre.

¹⁰ Të dhënat nga raportet e drejtorive të nivelit qendror të hetimeve dhe raporteve vjetor të DRP-ve

Tab. 4 Numri i rasteve dhe zbulueshmëria e tyre për vitin 2014 në DH (të shprehura dhe në përqindje) ¹¹							
	Nr. i rasteve	Të zbuluara		Nën hetime		z. Policor	Nr. i rasteve për z. policor
DHKO	78	39	50%	39	50%	39	2
DHTN	640	482	75%	158	25	93	7
DHTQNJ	155	110	71%	45	29%	54	3
DHKR	49	31	63%	18	37%	41	1
DHKEK	499	432	87%	67	13%	123	4
DKT	60	34	57%	26	43%	31	2
<i>Gjithsej</i>	<i>1 481</i>	<i>1128</i>	<i>76%</i>	<i>353</i>	<i>24%</i>	<i>381</i>	<i>4</i>

3.3.6 Për shpjegime të mëtejme ashtu siç edhe është theksuar në objektivin paraprak DIA, DTK, DMH, angazhimet e tyre nuk përcaktohen me numër të rasteve penale për shkak se tek këto drejtori angazhimet e tyre janë të një specifike më ndryshe duke qenë mbështetje e të gjitha rasteve të të gjitha drejtorive varësisht nga detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga to. Andaj, në tabelën paraprake nuk janë të vendosura këto tri drejtori.

3.3.7 Sa i përket angazhimeve të njësive hetimore në nivelin rajonal të dhënat nga raportet e tyre vjetore tregojnë se Njësia e Hetimeve Rajonale Prishtinë me 532 raste e përcjellur nga Njësia e Hetimeve Rajonale Ferizaj me 279 raste, kanë qenë më të ngarkuarat si me raste të përgjithshme ashtu dhe në raport me hetuesit. Ndërsa, sa i përket zbulueshmërisë së rasteve performancë më të mirë ka treguar Njësia e Hetimeve Rajonale Gjilan e cila ka arritur që nga totali prej 165 rasteve të zbulojë 150 duke trashëguar për vitin në vijim vetëm 15 raste. Në tabelën në vijim pasqyrohen të dhënat e drejtorive sa i përket numrit të hetuesve të angazhuar në raport me numrin e rasteve dhe zbulimet e veprave penale.

Tab. 5 Numri i rasteve dhe zbulueshmëria e tyre në Njësitë Hetimore të Drejtorive Rajonale për vitin 2014 (të shprehura dhe në përqindje) ¹²							
	Nr. i rasteve	Të zbuluara		Nën hetime		z. Policor	Nr. i rasteve për z. policor
Prishtinë	532	413	78%	119	22%	36	21
Pejë	224	184	82	40	18	28	6
Mitrovicë Veri	91	71	78%	20	22%	15	6
Prizren	229	203	89%	26	11%	29	8
Mitrovicë Jugu	225	189	84%	36	16%	28	8
Ferizaj	279	261	94%	18	6%	16	17
Gjilan	165	150	91%	15	9%	21	8
<i>Gjithsej</i>	<i>1745</i>	<i>1471</i>	<i>84%</i>	<i>274</i>	<i>16%</i>	<i>173</i>	<i>10</i>

¹¹ Të dhënat nga raportet e drejtorive të nivelit qendror të hetimeve

¹² Të dhënat nga raportet e DRP-ve

3.3.7 Ndërsa angazhimet e hetuesve në nivelin e stacioneve të kategorisë 'B' tregojnë se stacioni policor Lipjan me 1566 raste i përcjellur nga stacioni policor Suharekë me 1042 raste kanë qenë më të ngarkuarit si me raste të përgjithshme ashtu dhe në raport me hetuesit. Në tabelën në vijim pasqyrohen të dhënat e stacioneve policore sa i përket numrit të hetuesve të angazhuar në raport me numrin e rasteve dhe zbulueshmërinë e veprave penale. Ndërsa, stacioni policor Leposaviq ka treguar një performacë të mirë duke arritur që nga numri i përgjithshëm i rasteve të zbulojë shumicën nga to duke trashëguar për vitin në vijim vetëm 27 raste .

Tab. 6 Numri i rasteve dhe zbulueshmëria e tyre në sektorët hetimor të stacioneve policore të kategorisë "B" për vitin 2014 (të shprehura dhe në përqindje) ¹³							
	Nr. i rasteve	Të zbuluara		Nën hetime		z. Policor	Nr. i rasteve për z. policor
Lipjan	1566	972	62%	594	38%	12	130
Klinë	780	620	79%	160	21%	12	65
Leposaviq	161	134	83%	27	17%	8	20
Suharekë	1042	667	64%	375	36%	14	74
Skenderaj	648	396	61%	252	39%	15	43
Kaçanik	512	381	74%	131	26%	9	57
Kamenicë	596	476	80%	120	20%	11	54
Rahovec	596	396	66%	200	34%	9	66
<i>Gjithsej</i>	<i>5901</i>	<i>4042</i>	<i>68%</i>	<i>1859</i>	<i>32%</i>	<i>90</i>	<i>66</i>

3.3.8 Resurset humane dhe menaxhimi i duhur me to paraqet një kontribut të jashtëzakonshëm në performancën e hetimeve në PK. Por, përveç kësaj rol kyç luajnë kushtet dhe mjetet e nevojshme për punë si dhe mënyra e organizimit struktural të PK-së në drejtim të hetimeve.

3.3.9 Një tregues i mirë për PK-në është që gjatë inspektimit të gjitha subjektet e inspektuara kanë bërë dhe po bëjnë planifikimet e duhura drejtë parandalimit dhe luftimit të krimit duke u bazuar kryesisht në burimet dhe faktorët më të shpeshtë që po ndikojnë në dukuritë e paraqitjes dhe kryerjes së krimeve. Këto planifikime përveç që bëhen vjetore, varësisht nga shkalla e shfaqjes së dukurive kriminale dhe shkaktarëve të tyre hartohen edhe në baza javore apo edhe mujore.

3.3.10 Një mungesë bashkëpunimi dhe koordinimi brenda PK-së lidhur me shkëmbimin e informatave dhe dhënien e informatave kthyesë është mase evidente. Në këtë pikë gjatë inspektimit është vënë në pah se kjo ka ngecë si rezultat i mos angazhimit nga drejtoritë hetuese për të kthyer informatat e duhura dhe statusin e këtyre informatave. Kjo ndikon drejtpërdrejt në performancën policore të nxjerrjes së analizave dhe statistikave që kanë të bëjnë me veprimet e ndërmarra policore për hetimin dhe verifikimin e atyre informatave. Të gjitha njësitë hetuese të cilat marrin informacione të tilla duhet dhe e kanë obligim kthimin e tyre tek DIA me qëllim që të mos ketë dyfishim të rasteve të cilat duhet të hetohen dhe së këndejmi i njëjti informacion mos të shpërndahet në njësi hetimore të ndryshme për të njëjtën çështje.

¹³ Të dhënat nga raportet e DRP-ve

3.3.11 Njësitë e centralizuara në rajone policore që janë pjesë e drejtorive qendrore hetuese duhet të kenë bashkëpunim më të madh me hetimet rajonale dhe të krijojnë marrëdhënie me qëllim të dhënies dhe marrjes së informatave, me takime më të shpeshta me drejtoritë rajonale. Kjo i obligon drejtoritë konkrete hetuese të marrin për bazë këtë dhe të ushtrojnë një kontroll më të lartë të këtyre njësive dhe obligimin që të jenë më bashkëpunuese me rajonet policore ku operojnë.

3.3.12 Është vërejtur se në çdo stacion dhe regjion ekzistojnë praktika (forma) të ndryshme rreth evidentimit, trajtimit dhe menaxhimit të rasteve kriminale. Është rregull që rastet për çdo vit të fillojnë të regjistrohen sipas një rendi numrash, duke filluar nga numri 1. Mirëpo shpeshherë personeli që kishte evidentuar të dhënat kishte bërë kapërcim numrash, duke mos iu përmbajtur një vazhdimësie rendore¹⁴.

3.3.13 Për shkak të natyrës së veprave penale të cilat i hetojnë, personeli hetues duhet të ketë trajnime dhe kualifikime adekuate në raport me specifikat e veprave penale të cilat hetohen prej nivelit lokal deri te ai qendror. Inspektimi ka vënë në pah se hetuesit në sektorët e hetimeve në nivel stacioni dhe hetuesit në nivel rajonal përgjithësisht kanë të kryer kurset bazike dhe të avancuara hetimore.

3.3.14 Drejtoritë qendrore përveç kurseve të lartcekura kanë kryer edhe trajnime më të avancuara në nivel të vendit dhe jashtë tij. Për shkak që veprat penale në bazë të kompetencave lëndore iu takojnë tri niveleve hetuese, PK-ja duhet që në të ardhmen t'iu mundësojë trajnime të specializuara edhe hetimeve në stacione policore ashtu dhe rajonale. Kjo do të ndikojë në fitimin e njohurive më të gjera, shton efikasitetin dhe rritë performancën në drejtim të hetimit dhe zbulimit të krimit.

3.3.15 PK-ja me anë të trajnimeve si burim kyç ka arritur të përmirësojë aftësitë dhe të rris nivelin e performancës në fushën hetimore. Mirëpo, pavarësisht se ka personel me njohuri të mira hetuese dhe analitike, gjatë inspektimit dhe intervistave të zhvilluara është gjetur se ka mungesë të zyrtarëve policor si analistë të certifikuar, sidomos kur kërkohet që rasti të mbrohet në gjykatë nga eksperti që duhet të jetë i certifikuar. Përrjashtim nga kjo, në DHKEK si dhe në njësinë e hetimeve të krimeve kibernetike ka disa zyrtarë policor të cilët janë ekspert të certifikuar në fushën e hetimit te këto drejtori por, jo në numër të mjaftueshëm.

3.3.16 Në mënyrën e rekrutimit të zyrtarëve policor përmirësim është gjetur tek drejtoritë qendrore për hetimin e krimit, ku seleksionimi dhe rekrutimi i hetuesve bëhet përmes konkurseve të brendshme të cilat kanë kritere të veçanta për pranimin e hetuesve në këto drejtori.

¹⁴ Foto nga Libri për evidentimin e rasteve të v. 2014 në Stacionin Policor Kaçanik

3.3.17 Edhe pse me përvojë në kohë të gjatë në hetime personeli hetues në PK ka filluar të moshohet dhe ka nevojë për rifreskim të radhëve të saj. Në Ferizaj në sektorin e hetimeve të përgjithshme theksojnë se mosha e shtyrë e personelit po ndikon në zbulim të rasteve, ngase kjo po shpie në ngarkesë më të lartë të pjesës tjetër të personelit hetues. Këtë çështje e kanë potencuar edhe rajonet tjera dhe stacionet policore të inspektuara.

3.3.18 Gjatë analizimit të të dhënave nga raportet vjetore të secilit subjekt të inspektuar, vërehet se këto raporte nuk janë unike dhe standarde, nuk kanë të dhëna të mjaftueshme dhe në disa raste përmbajnë vetëm statistika numerike. Këto raporte duhet të jenë unike në të gjitha nivelet hetuese në kuadër të PK-së, të jenë më përmbajtjesore dhe të tregojnë saktë numrin e zyrtarëve policor që e përbëjnë njësinë e caktuar hetimore. Kjo do të mundësojë që të jepen analizat dhe statistikat e duhura për performancën hetimore policore gjatë një viti.

3.3.19 Në vazhden e krahasimeve lidhur me ngarkesën në punë për të gjitha subjektet e inspektuara stacionet e kategorisë “B” që janë inspektuar janë më të ngarkuara me punë ku shihet edhe në tabelën nr. 5. Këto stacione kanë këtë numër të madh të rasteve pasi që janë vija e parë e hetimit dhe merren me të gjitha llojet e veprave penale deri te ajo pjesë ku klasifikohen për kompetencë lëndore të mëtutjeshme ku në disa raste hasim në praktika të ndryshme të këtij klasifikimi. Stacionet policore të kategorisë “B” trajtojnë raste të natyrave më të lehta të veprave penale andaj edhe kanë numër më të madh të rasteve dhe koha e zbulueshmërisë së tyre është më e shkurtër në krahasim me hetimet rajonale dhe ato qendrore ku hetimi në këto të fundit për një rast mund të zgjasë me vite. Tabela po ashtu tregon se edhe personeli në stacionet e të njëjtit nivel është i ndryshëm.

3.3.20 Duhet cekur se ngarkesa e zyrtarëve hetues në të tri nivelet nuk përfshin tërë angazhimin e tyre në numrin e rasteve të paraqitura në tabela, ngase angazhimet e tyre përfshijnë edhe rastet e trashëguara nga vitet paraprake pastaj trajtimin e informatave, shkresave, urdhëresave, kërkesave, etj, të cilat vijnë si rezultat i veprimeve hetimore.

3.3.21 Zyrtarët policor të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Mitrovicë Jugut dhe Mitrovicë Veri, edhe për kundër faktit që ndërmarrin veprimet e nevojshme hetimore, duke përmbushur përgjegjësitë për ngritjen qoftë të kallëzimit penal apo raportit të veçantë, në procedurë të rregullt nuk bëjnë procedimin e mëtejme në prokurori me arsyetimin nga niveli prokurorial për numrin e vogël të prokurorëve si dhe mungesës së hapësirës dhe kushteve jo të përshtatshme në këto prokurori. Sektorët e hetimeve në këto rajone kanë pranuar një njoftim zyrtar nga ana e kryeprokurorit të prokurorisë themelore në Mitrovicë të Jugut, ku sqarohet rreth arsyes së mospranimit të rasteve nga ana e prokurorisë¹⁵.

¹⁵ Shkresa nga Prokuroria Themelore-Mitrovicë nr.:02/2013, dt. 14.01.2013

3.4. Menaxhimi i dosjeve penale nga PK-ja

3.4.1 Duke kryer detyrat konform autorizimeve ligjore, mbi policët hetues bie barra e veçantë në krijimin e dosjes kriminale, kompletimin me informacionet e nevojshme dhe menaxhimin e tyre. Policia ende nuk ka arritur të ketë ndonjë akt normativ që do të rregullonte atë se si duhet të jetë e përmbajtur një dosje kriminale.

3.4.2 Gjatë inspektimit në të tri nivelet hetimore IPK ka kontrolluar gjithsej dyzetë e tetë (48) dosje hetimore dhe atë: tetë (8) në nivelin qendror, gjashtëmbëdhjetë (16) në nivelin rajonal dhe njëzetë e katër (24) në nivelin e stacioneve.

3.4.3 Në të gjitha nivelet hetimore, inspektimi ka vënë në pah se dosjet kanë të bashkangjitura shkresat që kanë qenë pjesë e veprimeve hetimore. Varësisht nga përgjegjësia e njërive për përpilimin e shkresave bëhet dhe numërtimi i fletëve. Ajo që i ka karakterizuar këto dosje është se dosjet nuk kanë folder të posaçëm me specifika për çështje të ndryshme hetimore, shenja dalluese të secilit veprim hetimor. Po ashtu, shumica nga dosjet e kontrolluara nuk e kanë të bashkangjitur ndonjë shkresë e cila do të tregonte në tërësi përmbajtjen e dosjes, duke e përcjellur një mos numërtim i përgjithshëm i fletëve që përmban dosja hetimore. Mbajtja e këtyre evidencave do të përmirësonte performancën e njërive hetimore policore dhe po ashtu, minimizon mundësitë në shmangiet e mundshme të dokumenteve brenda dosjeve duke ngritë në nivel më të lartë shkallën e sigurisë së tyre.

3.4.5 Në të gjitha dosjet e kontrolluara standardi i përpilimit të kallëzimeve penale është i ndryshëm dhe jo unik. Përpilimi i duhur i kallëzimeve penale nga zyrtarët policor është thelbi i hetimit të një rasti, meqë përmes tyre njoftohen prokurorët mbi natyrën e veprës, personat e dyshuar, mënyrën e kryerjes së veprës dhe veprimet që janë ndërmarrë nga zyrtarët policor.

3.4.6 Siç është theksuar më lartë, PK-ja ende nuk ka krijuar një udhëzues me të cilin do të përcaktohej se si të menaxhohen dosjet penale, cilat dokumente dhe formularë duhet të ketë një dosje penale dhe të gjitha këto dokumente të jenë unike dhe të përdorshme në çdo nivel hetues. Në këtë pikë gjatë inspektimit hasëm në iniciativat e ndërmarra nga PK-ja dhe Prokuroria për krijimin e një drafti me të cilin do të përfshihen dokumentet që duhet të përmbajë një dosje penale dhe si të menaxhohen ato. Kjo iniciativë është e mirëseardhur dhe duhet që sa më shpejt PK-ja dhe akterët tjerë të fillojnë në finalizimin e saj dhe implementimin në praktikë.

3.4.7 E gjetura në terren gjatë inspektimit ka treguar se PK ka përpiluar një procedurë standarde të operimit (PSO-se me nr. DSHB-1.05) për Menaxhimin e Dokumenteve Arkivore, Njësia e Arkivit së cilës duhet t'i nënshtrohen për zbatim të saj të gjitha departamentet, divizionet, DRP-të dhe sektorët tjerë, ku në detaje përcaktohet mënyra e klasifikimit, rregullimit, kujdesit dhe ruajtjes së dokumenteve zyrtare.

3.4.8 Arkivi është sektor me rendësi të lartë në PK dhe sipas PSO-së ajo duhet të jetë në vend të përshtatshëm dhe të sigurt brenda objektit të PK-së, muret duhet të jenë të ndërtuara me material të fortë, me ç'rast dyshemeja dhe tavani duhet të jenë rezistence ndaj zjarrit dhe faktorëve të tjerë. Për çështje të sigurisë më të lartë, dera arkivuese duhet të jetë e punuar nga metali dhe në hyrje të arkivës duhet të vendosen video-kamera monitorimi.

3.4.9 Arkivi (dhoma e dosjeve) është vendi-hapësira brenda institucionit në të cilën bëhet grumbullimi, ruajtja, sistemimi dhe përpunimi i dokumenteve të krijuara nga veprimtaria e institucionit. Në subjektet e inspektuara është bërë shikimi vizual i arkivave për të vlerësuar gjendjen reale për mënyrën e ruajtjes dhe sigurisë së dosjeve. Të gjeturat tregojnë gjendje jo të mirë të arkivave (dhomat e dosjeve). Ato janë të vendosura në hapësira të adaptuara të cilat janë të destinuara për zyre (dhoma pune), në anekse të ndërtuara jashtë objektit të policisë (por që janë pjesë e objektit të policisë) dhe në kontejner (të vendosur brenda hapësirës së oborrit të objektit të PK-së).

3.4.10 Kushtet e tanishme në të cilat funksionojnë arkivat në kuadër të departamenteve dhe njësisive hetimore të PK-së nuk ofrojnë siguri për dosjet të cilat janë të arkivuara brenda arkivës. Dyert e arkivave në PK janë të punuara nga druri, në hyrje të tyre nuk ka të vendosura video-kamera për monitorim dhe nuk ka stabilimente që ofrojnë kushte konstante për ruajtjen e temperaturës dhe shmangien e lagështisë për t'i ikur dëmtimit të dosjeve.

3.4.11 Në Departamentin e Hetimeve në PK, nuk kemi hasur në arkiva në kuadër të drejtorive apo sektorëve të cilat janë të rregulluara dhe plotësojnë kushtet për arkiv dhe arkivim të dosjeve. Menaxherët kanë adaptuar zyra (dhoma) duke u orvatur që hapësira të jetë e përshtatshme dhe e sigurt dhe inventari i vendosur brenda tyre të mundësojë ruajtjen, menaxhimin dhe mbrojtjen e lëndës nga faktorët dëmtues. Në përgjithësi, inventari brenda zyrave të arkivave, nuk i plotëson kushtet e parapara si në aspektin fizik ku janë të vendosura dosjet ashtu dhe aspektet tjera (ajrosja, lagështia, sistemimi etj). Gjatë zhvillimit të inspektimit është gjetur se aty ruhen edhe pajisje të tjera të policisë të cilat gjenden jashtë përdorimit si p.sh. kompjuter, TV, mjete higjienike etj¹⁶.

3.4.12 Sistemimi i dosjeve është diktuar nga iniciativat personale të zyrtarëve policor përgjegjës të dhomës së arkivës dhe personelit komandues të tyre. Në dhomat arkivuese (të dosjeve) nuk kanë listë njoftuese apo libër fizik që tregon saktë vendin e sistemimit të dosjes dhe përmbajtjen e saj.

3.4.13 Të gjitha nivelet hetimore duhet të posedojnë librin zyrtar të evidentimit në të cilin pos tjerash evidentohet qasja e zyrtarëve hetues apo personelit të pa autorizuar në arkiv, pranim-dorëzimi i dosjeve si dhe përmbajtja e dosjes e cila ka lëvizur. Mirëpo, duhet theksuar që këto

¹⁶ Foto dëshmi nga arkivat e inspektuara

njësi kanë modifikuar në veçanti disa libra në të cilat përmbushin përgjegjësitë e cekura më lartë.

3.4.14 Performanca policore dhe etika e mirëmbajtjes, ruajtjes dhe administrimit të dosjeve në kuadër të departamentit të hetimeve varet edhe nga kushtet dhe hapësirat që ofrojnë objektet policore. Në DRP Prizren dhe Gjilan një pjesë e arkivës (dhoma e dosjes) është e vendosur në kontejner brenda oborrit të DR-së (jashtë ndërtesës së DRP-se). Në Stacionet Policore të kategorisë "B" (Leposaviq dhe Skenderaj), nuk ka dhomë të caktuar për arkiv, ruajtja e dosjeve bëhet në zyrën në të cilin është i vendosur zyrtari përgjegjës për sistemim të rasteve në SIPK dhe punonjës të tjerë policor. Po ashtu, në të njëjtin vend ruhen edhe dosjet e rasteve penale të cilat për arsyet e lartcekura nuk kanë mundur të procedohen në prokurorinë kompetente.

3.4.15 Arkiva (dhoma e dosjes) në Stacionin Policor në Kamenicë në kohën e zhvillimit të fazës inspektuese ka qenë në tërësi jashtë funksionit për shkak të depërtimit të ujërave të zeza në të pasi ajo është e vendosur në katin përdhësë në këtë stacion policor. Aty ka qenë e pamundur të bëhet shikimi i arkivës, sepse qasja në të ka qenë e ndaluar nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës. Kjo dukuri është shqetësuese ngase është përsëritur disa herë dhe zgjidhja e këtij problemi nuk është evituar ende. Pavarësisht kësaj, menaxhmenti i Stacionit Policor të Kamenicës duhet të ndërmarrë masa për të evituar këtë problem apo nëse lejojnë hapësirat e objektit arkivi të dislokohet në katet e sipërme.

3.4.16 Gjatë inspektimit është vërejtur se ekzistojnë librat për evidentim fizik të rasteve/lëndëve penale por, këto libra nuk janë të njëjtë në të gjitha rastet dhe se ato ndryshojnë në emërtime, por, inspektimi ka vënë në pah se përmbajtja e tyre e regjistrimit të rasteve është e njëjtë.

3.4.17 Përveç evidentimit fizik, rastet e hetuara pas përfundimit të procesit hetimor, të dhënat e tyre futen në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK) apo evidentimin elektronik të rasteve në të cilin evidentohen krimet bazuar në listën e veprave penale të specifikuara me Kod Penal dhe ky proces evidentues ekziston në të gjitha subjektet e inspektuara. Por, përveç SIPK-ut, njësitet hetimore kanë prezantuar edhe libra elektronik vetanak në të cilët mbajnë të dhënat për rastet penale.

3.4.18 Futja e të dhënave në SIPK është e rregulluar me PSO¹⁷ e cila përmban udhëzime për personelin policor në lidhje me SIPK. Ky dokument ka për qëllim që të normojë veprimet e personelit policor në qasje me SIPK dhe të harmonizojë procedurat policore me evidentimin e shënimeve policore në fushat e përgjegjësisë konkrete, në lidhje me veprat e ndodhura penale, kundërvajtjet në trafik, incidentet jo kriminale, verifikimin e personave dhe automjeteve, nxjerrjen e të dhënave statistikore dhe analizave të ndryshme.

¹⁷ Sistemi informativ i PK-së nr. ZDPO-02/020/14, dt. 27/11/2014

3.4.19 Në disa stacione policore të inspektuara (DR e Mitrovicës së Jugut dhe Veriut) theksojnë se kanë probleme me rifreskimin e të dhënave në SIPK për shkak të ngeçjes së komunikimit me organet e ndjekjes dhe si rrjedhojë kjo paraqet shqetësim për kërkuesit e informacioneve (qytetarët) lidhur me statusin e tyre në raport me drejtësinë dhe verifikimin e së kaluarës.

4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

4.1 Përfundimet

4.1.1 Struktura organizative e PK-së në hetimin dhe zbulimin e krimit është e organizuar në tri nivele hetimore: qendror (DH); nivel rajonal të hetimeve në DRP (NJHR-të) dhe në nivel lokal (njësitë hetuese të stacioneve policore). Struktura e tanishme në të tri këto nivele ende nuk ka arritur të jetë përmbushëse ku për këtë pjesë inspektimi dhe analizimi i saj vë në pah nevojën për një ristrukturim, sidomos në drejtoritë e specializuara të hetimit të krimit.

4.1.2 Në të gjitha nivelet hetimore është bërë shpërndarja e personelit dhe atë duke përmbushur me gradat e parapara, por të cilat në disa raste ka pasur qoftë tejkalim apo dhe shkëputje të zinxhirit komandues të nivelit të hierarkisë së gradave.

4.1.3 Vlen të theksohet që përcaktimi në strukturë organizative në nivelin e hetimeve qendrore të njësive për dhunë në familje dhe delikuencë për të mitur nuk është për të nënvlerësuar trajtimin që iu jepet këtyre dy çështjeve por, nuk ka një përputhshmëri në mes funksionalizimit strukturor të njësive së dhunës në familje pasi që shumë mënyra të dhunës në familje përbëjnë vepra të ndryshme penale të cilat janë të parapara në KPK dhe që trajtohen nga ana e njësive të tjera të profilizuara në PK.

4.1.4 Policia e Kosovës ka arritur që të përmbushë detyrimet me plotësimin e çështjeve përcjellëse ligjore që dalin si kërkesa të akteve më të larta ligjore për trajtime hetimore. Mirëpo disa nga kërkesat që dalin nga këto akte siç janë KPPK kërkojnë një detajim më të mirëfilltë të dokumentacioneve përcjellëse siç është rasti tek veprimet hetimore të përcaktuara në nenin 70 paragrafi 3 pika nga 3.1 deri në 3.13 si dhe në vazhdimësi paragrafi 3.

4.1.5 Për më tutje njësitë hetimore në mënyra të tjera zakonisht kanë arritur që të përmbushin obligimin e tyre që rrjedh nga neni 70 paragrafi 4 i KPPK-së, por që në të shumtën e rasteve nuk kanë dorëzuar raport policor prokurorit të shtetit.

4.1.6 Policia e Kosovës ka arritur të krijojë PSO për kompetencën lëndore me të cilën ka bërë ndarjen e kompetencave për trajtim të veprave penale për hetim të secilit nivel por, në disa raste kjo kompetencë i ka paraparë që një vepër penale të hetohet nga tri nivele hetuese. Mirëpo, kjo PSO ka nevojë për një rishikim në përmbajtje të saj e cila do të specifikonte në mënyrë sa më të detajuar të mundshme rrethanat kur një vepër penale mund të hetohet në të tri nivelet.

4.1.7 Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë të Informacionit tërë angazhimin e saj e ka përqendruar për të mbështetur të gjitha njësitë hetimore me informacione dhe analiza. Por, kjo drejtori në disa raste është përballur me situata kur njësitë tjera hetimore nuk kanë bërë kthimin

e informacionit kësaj drejtorie në mënyrë që më pastaj ajo të ketë pasqyrim të qartë dhe mbështetje të mirëfilltë për këto njësi.

4.1.8 Në të gjitha njësitë hetimore është vënë në pah një mënyrë e ndryshme e secilës njësi pra jo e standardizuar sa i përket mirëmbajtjes së dosjeve hetimore dhe mënyrës së menaxhimit në aspektin e folderëve përmbajtësor i cili do të specifikonte gjërat sa i përket mënyrës së radhitjeve, shenjave dalluese, numërtimit të përgjithshëm dhe detajeve që lidhen me dokumentacionet hetimore.

4.1.9 Në të gjitha nivelet hetimore është vërtetuar se në arkiva (dhoma të dosjeve) nuk posedojnë libra zyrtarë për evidentim por kanë të modifikuar regjistra (hyrje-dalje) për qasje në arkiva ku janë të vendosura dosjet hetimoret e të cilat në një farë mënyre i përmbajnë të dhënat për verifikim eventual të lëvizjes së dosjes hetimore.

4.1.10 Sa i përket arkivimit mbetet shumë për tu bërë në aspektin e ruajtjes së dosjeve, ngase gjendja e gjetur gjatë këtij inspektimi tregon për nivel jo të mirë duke improvizuar hapësira që shërbejnë si arkiva për ruajtjen e dosjeve penale.

4.2 Rekomandimet

1. IPK rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë që të krijojë një grup të ekspertëve të cilët do të analizojn çështjen e drejtorive mbështetëse në nivelin qendror në mënyrë që të bëjnë një ristrukturim më të mirëfilltë i cili do të krijonte mbarëvajtje dhe lehtësim në kryerjen e detyrave të përditshme hetimore.
2. IPK rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë që të sigurohet se është intensifikuar bashkëpunimi në mes Departamentit për Hetime dhe Departamentit për Burime Njerëzore me qëllim të shqyrtimit dhe gjetjes së mënyrave përmes së cilave do të sigurohen se përmbushja e personelit bëhet ashtu siç e ka paraparë struktura organizative si dhe të mos ketë shkëputje (hapësira) në nivelin e respektimit të hierarkisë së gradave.
3. IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës që konform strukturës organizative të risistemojnë njësinë e dhunës në familje dhe delikuençë me të mitur e cila njësi do të ketë dhe do të menaxhojë çështjen e të dhënave të përgjithshme të rasteve të ndryshme penale që trajtohen si rezultat i dhunës në familje.
4. IPK rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë që të angazhohet në krijimin e një grupi nga të tri nivelet hetimore të cilët do të punonin në përpilimin e një dokumenti (formulari) që do të përfshinte në vete veprimet hetimore të autorizuara fillestare të policisë me qëllim që më pastaj të kenë pasqyrim më të qartë në procesin procedural si mënyrë që do të lehtësonte angazhimet nga ana e hetuesve.
5. IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës të sigurohet që në rrethanat kur hetimet ndërtojnë 'dyshimin e arsyeshëm' se është kryer një vepër penale brenda njëzetë e katër orëve (24) të respektojnë dispozitën ligjore nga KPPK, për të dorëzuar raportin policor prokurorit të shtetit që është kompetent.
6. IPK rekomandon menaxhmentin e lartë kompetent që të rishikojë dhe plotësojë PSO-në (/ZDPO/02/023/2013) për Kompetencë Lëndore në mënyrë sa më të detajuar të mundshme duke përcaktuar specifikat-rrethanat kur një vepër penale mund të hetohet në të tri nivelet.
7. IPK rekomandon menaxhmentin e lartë kompetent të secilit nivel hetimor të sigurohen që hetuesit të jenë më të kujdesshëm dhe azhur në kthimin e informatave tek DIA, në mënyrë që kjo drejtori të përmbushë detyrimet e saj duke pasur pasqyrim dhe shpërndarje më të mirëfilltë të informacionit dhe analizës tek të gjitha njësitë.

8. IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës hetimor të angazhohen në krijimin e një standardizimi të mënyrës së menaxhimit të dosjeve hetimore duke parashtruar kërkesa me specifika për tu furnizuar me folder përmbajtësor për fushën hetimore me qëllim të ruajtjes së mirëfilltë të dosjeve.
9. IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës që të sigurohen se të gjitha arkivat e dosjeve hetimore të jenë të pajisura me libra zyrtarë të evidentimit të cilat do të duhej të plotësoheshin në përputhje me specifikat që i parasheh.
10. IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës që të merr masa për zbatimin e PSO-së për arkiva dhe ruajtjen e dosjeve si dhe të krijojë kushtet e nevojshme për arkivim duke filluar nga hapësira (ambienti) për arkivë, raftet e domosdoshme dhe pajisjet tjera përcjellëse për sigurim, ndriçim dhe ajrosje.

1. PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE

Nr	Rekomandimi	Komentet
1	<p>IPK rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë që të krijojë një grup të ekspertëve të cilët do të analizojn çështjen e drejtorive mbështetëse në nivelin qendror në mënyrë që të bëjnë një ristrukturim më të mirëfilltë i cili do të krijojte mbarëvajtje dhe lehtësim në kryerjen e detyrave të përditshme hetimore.</p>	<p>Me datë 05.05.2015 Drejtori i Përgjithshëm z. Shpend Maxhuni ka mbajtur një takim me stafin menaxherial për të diskutuar rreth çështjes së listës së autorizuar të Personelit për të marre rekomandimet nga stafi lidhur me draftin e propozuar në këtë mbledhje(Takim ky i cili ka pasuar me nënshkrimin e listës së autorizuar të aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm me datë 07.05.2015.</p> <p>Vlen të ceket se në këtë takim dhe takimet tjera Drejtori ka kërkuar nga Drejtorët e Departamenteve që të fillojnë me analizimin dhe identifikimin e nevojave për plotësim ndryshim të Strukturës Organizative andaj ka kërkuar që secili Departament të këtë analize të tilla dhe pastaj të formohet një grup punues i cili do të hartoj draftin për ristrukturim të njësiteve dhe Drejtorive . JEMI NE FAZËN E PËRGATITJES SE PROPOZIMEVE të cilat do të dërgohen tek Drejtori i Përgjithshëm i cili do të formoj grupin punues për analizimin e propozimeve dhe Draftimin e draftit final.</p>
2	<p>IPK rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë që të sigurohet se është intensifikuar bashkëpunimi në mes Departamentit për Hetime dhe Departamentit për Burime Njerëzore me qëllim të shqyrtimit dhe gjetjes së mënyrave përmes së cilave do të sigurohen se përmbushja e personelit bëhet ashtu siç e ka paraparë struktura organizative si dhe të mos ketë shkëputje (hapësira) në nivelin e respektimit të hierarkisë së gradave.</p>	<p>Ne takimin javor të rregullt të mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm i PK-së me stafin menaxherial te datës 17.08.2015 Drejtori I PK-së ka kërkuar nga Drejtori i Departamentit për Burimeve që të përgatisin listat e zyrtareve të cilët për shkak të ndryshimit të emërimit të njësisë apo sektorit të dhënat nuk përputhen me emërtime duhet të sistemohen sipas emërtimeve të reja konform strukturës organizative dhe Listës së autorizuar të personelit. Departamenti për Burime Njerëzore përkatësisht Kol. Taibe Canolli me datë 18.08.2015 ka shpërndarë një shkresë me të cilën kërkohet që të rekomandojnë dhe të propozojnë sistemin e stafit sipas emërtimeve të Drejtori/ Njësiteve bazuar në strukturën aktuale në fuqi. JEMI NE PROCES TE PERGADITJES SE PROPOZIMEVE.</p>
3	<p>IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës që konform strukturës organizative të risistemojnë njësinë e dhunës në familje dhe delikuencë me të mitur e cila njësi do të ketë dhe do të menaxhojë çështjen e të dhënave të përgjithshme të rasteve të ndryshme penale që trajtohen si rezultat i dhunës në familje.</p>	<p>Është risistemuar, bazuar në listën e autorizuar të personelit datë 07.05.2015 është aprovuar dhe nënshkruar Struktura Organizative nga Drejtori i Përgjithshëm i PK-së datë 01.06.2015 andaj konsiderojmë se rekomandimi është i përfunduar.</p>

4	<p>IPK rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë që të angazhohet në krijimin e një grupi nga të tri nivelet hetimore të cilët do të punonin në përpilimin e një dokumenti (formulari) që do të përfshinte në vete veprimet hetimore të autorizuar fillestare të policisë me qëllim që më pastaj të kenë pasqyrim më të qartë në procesin procedural si mënyrë që do të lehtësonte angazhimet nga ana e hetuesve.</p>	<p><i>Është formuar Grupi punues ne nivel qendror i cili grup është ne kontakt te vazhdueshëm me nivelin lokal duke shpërndarë materialin dhe duke pranuar rekomandime nga niveli lokal, grup ky i cili është duke punuar me ekspertet ndërkombëtar të BE-së të angazhuar nga Projekti i Binjakëzimit” Fuqizimi i kapaciteteve ne parandalimin dhe luftimin e Krimet të Organizuar dhe Korrupsionit”</i> <i>Drafti i Parë është përgatitur dhe pritet te finalizohet ne muajin Tetor 2015</i></p>
5	<p>IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës të sigurohet që në rrethanat kur hetimet ndërtojnë ‘dyshimin e arsyeshëm’ se është kryer një vepër penale brenda njëzetë e katër orëve (24) të respektojnë dispozitën ligjore nga KPPK, për të dorëzuar raportin policor prokurorit të shtetit që është kompetent.</p>	<p><i>Ju është shpërndarë rekomandimi zyrtarëve përgjegjës për hetime ne gjithë policinë e Kosovës dhe pritet implementimi praktik i këtij rekomandimi.</i></p>
6	<p>IPK rekomandon menaxhmentin e lartë kompetent që të rishikojë dhe plotësojë PSO-në (/ZDPO/02/023/2013) për Kompetencë Lëndore në mënyrë sa më të detajuar të mundshme duke përcaktuar specifikat- rrethanat kur një vepër penale mund të hetohet në të tri nivelet.</p>	<p><i>Zëvendës Drejtori i përgjithshëm i PK-së z. Naim Rexha ka potencuar disa herë në takime se duhet të rishikohet kjo Procedurë dhe ka dhënë sugjerime që të bëjmë një analizë te ndryshimit të ligjeve e cila reflekton në këtë PSO,e pastaj te formoj grupin i cili do të filloj me draftimin e dokumentit të plotësuar.</i></p>
7	<p>IPK rekomandon menaxhmentin e lartë kompetent të secilit nivel hetimor të sigurohen që hetuesit të jenë më të kujdesshëm dhe azhur në kthimin e informatave tek DIA, në mënyrë që kjo drejtori të përmbushë detyrimet e saj duke pasur pasqyrim dhe shpërndarje më të mirëfilltë të informacionit dhe analizës tek të gjitha njësitë.</p>	<p><i>Lidhur me këtë rekomandim janë përpiluar disa dokumente “ Strategjia Policimi i Udhëhequr nga Inteligjenca” PSO-ja “Detyrat e zyrtarëve Policor në Procesin e Inteligjencës, Dokumenti, është realizuar dhe shpërndare fletushka për te informuar zyrtaret policor për rëndësinë e përpilimit të informatave Inteligjente, Zyrtarëve policor i janë shpërndarë kartela informuese me nocionet themelore dhe rëndësin e Inteligjencës, Është funksionalizuar sistemi i ri i SIPK-ut, i cili mundëson dhe lehtëson dhënien e Informatave kthyesë, e cila me rastin e zbatimit të të lartcekurave konsiderojmë se do te jepen rezultate konkrete ne dhënien e Informatave kthyesë.</i></p>
8	<p>IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës hetimor të angazhohen në krijimin e një standardizimi të</p>	<p><i>Grupi punues i cili është përshkruar rubrikën e komentit të rekomandimit Nr. 4 të këtij dokumenti ju ka dhënë detyre qe me rastin e draftimit dhe finalizimit të</i></p>

	mënyrës së menaxhimit të dosjeve hetimore duke parashtruar kërkesa me specifika për tu furnizuar me folder përmbajtësor për fushën hetimore me qëllim të ruajtjes së mirëfilltë të dosjeve.	<i>Udhëzuesit të përshkruaj një kapitull të veçantë (Drafti është i përgatitur) i cili ka të bëjë me standardizimi të mënyrës së menaxhimit të dosjeve hetimore duke parashtruar kërkesa me specifika për tu furnizuar me folder përmbajtësor për fushën hetimore me qëllim të ruajtjes së mirëfilltë të dosjeve.</i>
9	IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës që të sigurohen se të gjitha arkivat e dosjeve hetimore të jenë të pajisura me libra zyrtarë të evidentimit të cilat do të duhej të plotësoheshin në përputhje me specifikat që i parasheh.	<i>Menaxhmenti i Departamentit të Hetimeve ka marrë për obligim që të zbatoj këtë rekomandim duke bërë porosinë e regjistrave të cilët do të jenë unik në të gjitha dhomat e dosjeve, Ky rekomandim do të plotësohet deri në fund të vitit 2015</i>
10	IPK rekomandon menaxhmentin udhëheqës që të marrë masa për zbatimin e PSO-së për arkiva dhe ruajtjen e dosjeve si dhe të krijojë kushtet e nevojshme për arkivim duke filluar nga hapësira (ambienti) për arkivë, raftet e domosdoshme dhe pajisjet tjera përcjellëse për sigurim, ndriçim dhe ajrosje.	<i>Pasi të jetë i aprovuar Udhëzuesi për të cilin janë duke punuar grupi punues me ekspertet e BE-së në kuadër të Projektit të bijankëzimit (Konsiderojmë në Tetor 2015 të aprovohet dhe hyn në fuqi Udhëzuesi i Përbashkët me Prokurorinë e Shtetit) Do të ndërmerren masat adekuate për të porositur materialin e nevojshëm konform këtij Udhëzuesi, si dhe përpilimin e PSO-së konform këtij Dokumenti.</i>